



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM ✓

Nr. 581/2 Prot.

Tiranë, më 21.02, 2025

**Drejtuar:** KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE  
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

**Për dijeni:** Z. Ilirjan CELIBASHI  
KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Lënda:** Ankimim i pikës 1 të vendimit nr.117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më datë 19.02.2025, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**Kërkues:** Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/  
KRIJK

**Subjekt:** Zj. Elisa Spiropali/ Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**Palë e interesuar:** Kuvendi i Shqipërisë

**Objekt:** Marrja e hapave të nevojshëm për të parandaluar ecurinë e shqyrtimit të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", pasi miratimi i tij përbën një shkelje të Kodit Zgjedhor.

Gjatë shqyrtimit të çështjes administrative të sipërcituar, ndër të tjera u bë me dije që nxitur nga qëllimi i denoncimit të KRIJK, objekt shqyrtimi i këtij procedimi administrativ, KQZ shqyrtoi projektligjet të cilat janë në kalendarin dhe programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë për periudhën nga data 20 Janar deri më datën 28 Shkurt 2025.

Sipas Komisionerit, konstatohet se:

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i propozuar nga deputeti z. Nasip Naço, është parashikuar për t'u përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 10 shkurt - 28 shkurt, miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 30.01.2025. Bazuar në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndalimet për propozimin, miratimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

Nga hetimi administrativ u provua se projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i propozuar nga deputeti z. Nasip Naço", ofron përfitime të drejtëpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht të atyre që vuajnë dënimin në sistemin peniteciar në vend.

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", ofron rregullim të kuadrit ligjor duke ju dhënë mundësi më të shpejtë të dënuarve të kalojnë në një institucion me një nivel më të ulët të sigurisë, përfshirë këtu edhe të dënuarit pranë institucioneve të sigurisë së lartë.

Po ashtu projektligji objekt hetimi administrativ ofron mundësi të kalimit në Institucionet e hapura të vuajtjes së dënimit për të dënuarit me burgim që e vuajnë atë pranë institucioneve të sigurisë së ulët dhe që u ka mbetur më pak se 2 vjet e 6 muaj burgim për të vuajtur, duke ndryshuar kushtin prej 6 muajsh që është aktualisht i parashikuar nga ligji. Në vijim pika 3, e nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, ka shtuar në listën e akteve të ndaluara edhe aktet me anë të të cilave parashikohet dhënia e përfitimeve që favorizojnë një kategori të caktuar të popullsisë.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr 117, datë 19.02.2025 në pikën 1 ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit të mos përfshijë për shqyrtim në Seancë Plenare projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se pika 1 e vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe bie në kundërshtim me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, ju bëj me dije se vendimi nr.117, datë 19.02.2025 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka pasaktësi juridike, pasi objekti i vendimit bie në kundërshtim me pikën 2 të këtij vendimi, konkretisht:

"2. T'i rekomandohet Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin "Për paketën e maleve" dhe Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"."

Komisioni në argumentat e tij ka parashtruar:

*Konstatohet se fusha e veprimit të projektligjit, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", propozuar nga deputet z. Agron Duka, favorizon një kategori të popullsisë, përkatësisht fermerët të cilët përfitojnë në skemat e pagesave dhe subvencioneve direkte.*

*Ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve. Ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale.*

**Këto pasaktësi juridike mund të kenë ndikuar gabimisht në vendimmarrjen e komisionerit, pasi duke pasur parasysh parashikimet e akteve të tjera ligjore, është konkluduar se projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" ofron përfitime të drejtëpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë. Edhe nëse bëjmë një analizë paralele me sa parashikon neni 380 i Kodit të Procedures Penale "Për të marrë vendimin, Gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose verifikuar në shqyrtimin gjyqësor".**

## ANALIZA LIGJORE

Lidhur me këtë vendim, Kuvendi i Shqipërisë nuk është dakort me pikën 1 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me argumentet si më poshtë vijon:

Neni 91 i Kodit Zgjedhor përcakton se:

*"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore."*

Vendimi nr. 9, datë 20.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 3, pika 3, përcakton:

*"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljen e kamatëvonesave, të globave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë."*

Sa parashikohet më sipër, projektligji:

- **nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave;**

- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pensioneve;
- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë mbështetje ekonomike;
- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë uljen e taksave;
- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë heqjen e taksave;
- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë vendosjen e amnistive fiskale;
- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë privatizimin e pasurive a të shpërblimeve;
- nuk parashikon dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë dhënien e pasurive a të shpërblimeve.

Interpretimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë është i zgjeruar dhe tejkalon parashikimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Për më tepër në jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor dhe praktikat administrative të KQZ-së, është theksuar qartë se **ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale gjatë periudhës së ndalimit duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe të kufizuar**. Kjo do të thotë se vetëm ato veprime që kanë një efekt të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në zgjedhje mund të konsiderohen si shkelje të Kodit Zgjedhor.

*Në këtë rast, efektet e ligjit nuk janë të menjëhershme, nuk kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zgjedhjet dhe ajo çka është më e rëndësishme nuk janë në asnjë moment në kushtet e ndalimit të parashikuar ligjor.*

Prandaj, nuk mund të argumentohet se ligji ka qenë një mjet për të fituar përfitime elektorale.

#### **Mbi mungesën e krijimit të një përfitimi apo avantazhi elektorale të paligjshëm**

Referuar relacionit vënia në zbatim e parashikimit ligjor mbi regjimin e hapur duke propozuar që afati nga 6 muaj të bëhet 2 vjet e 6 muaj si dhe propozimi për ndryshimin e metodologjisë së klasifikimit të sigurisë së të dënuarve, **nuk është një propozim tërësisht i ri**, por **përmirësim** i dispozitave aktuale të ligjit dhe vënia në zbatim e tyre. Ndryshimi i metodologjisë së klasifikimit të sigurisë synon të rrisë efikasitetin e procesit, duke e bërë atë më të shpejtë dhe më pak të ngarkuar për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Këto ndryshime janë të rëndësishme për të adresuar sfidat e menaxhimit të të dënuarve, mbipopullimin dhe për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të burgjeve, pa cenuar të drejtat e palëve.

**Amendimet e propozuara synojnë të përmirësojnë efikasitetin në menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Kjo ndihmon në mirë organizimin e burimeve njerëzore, logjistike dhe në menaxhimin më të mirë të sigurisë.** Gjithashtu ndihmojnë në forcimin e politikave që promovojnë rehabilitimin e të dënuarve, duke i inkurajuar ata të punojnë për përmirësimin e indikatorëve rehabilitues.

Sikurse shpjeguar në relacion, referur statistikave si dhe referuar parashikimeve aktuale ligjore, **të dënuar që vuajnë dënim në burgje të hapura është (0) zero. Referuar parashikimeve të nenit 58 të Kodit Penal, vendime të dhënë nga gjykata me gjysëmliri janë (0) zero . Gjithashtu referuar parashikimeve aktuale ligjore dhe statistikave, te kategoria e institucioneve të sigurisë së ulët, në**

**ligj është parashikuar se : “ Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët janë institucionet ku ekzekutohet dënimi për të dënuarit, për kundravajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon pesë vjet burgim ”. Duke parë statistikat për të dënuarit në këto institucione janë ( 0 ) zero.**

Aktualisht kalimi nga siguria e lartë e një të dënuari në një burg të sigurisë së zakonshme bëhet, por vetëm nëpërmjet gjykatës duke sjellë zvarritje në gjykim dhe në dhënien e vendimit pasi nuk është bërë përcaktimi në ligj se në cilat raste gjykata duhet të shqyrtojë një kërkesë, kur kalohet nga burgu i sigurisë së lartë në një burg të sigurisë së zakonshme. Me ndryshimet e propozuara të drejtën për të bërë këtë kalim e ka drejtori, i dënuari ose të përfaqësuesit i tij ligjor në rast se i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënimit. Vlerësimi i rrezikshmërisë së të dënuarit do të bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara qartë në ligj.

### **Mbi mungesën e efekteve të menjëhershme**

Duam të sjellim në vëmendjen e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve faktin se një tjetër aspekt që duhet të merret parasysh është se efektet e këtij ligj nuk janë të menjëhershme. Ky aspekt është i rëndësishëm sepse neni 91 i Kodit Zgjedhor ndalon përdorimin e burimeve publike për qëllime elektorale gjatë periudhës së ndalimit, e cila fillon katër muaj para zgjedhjeve dhe zgjat deri në formimin e qeverisë së re. Meqenëse efektet e ligjit nuk janë të menjëhershme dhe nuk do të jenë të dukshme gjatë kësaj periudhe, nuk mund të argumentohet se ligji ka qenë një mjet për të fituar përfitime elektorale. Kjo gjë evidentohet edhe për faktin se gjatë shqyrtimit në komision, deputetët e mazhorancës dhe opozitës ngritën shqetësimin se kjo nisëm mund të bjerë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut **vendosi t'i sugjerojë komisionit përgjegjës hyrjen në fuqi të këtij ligji, pas zgjedhjeve të 11 Majit**, duke shmangur në këtë mënyrë edhe aludimet për përdorimin e nismës në kundërshtim me sa më sipër.

Gjithashtu, sqarojmë se Komisioni për Sigurinë Kombëtare akoma nuk ka vijuar me shqyrtimin nën nën të projektligjit, pasi ka planifikuar zhvillimin e seancave dëgjimore me grupet e interesit, ku sugjerimet e tyre së bashku me mendimin e Këshillit të Ministrave, ku përfshihen edhe sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë, do të reflektohen gjatë shqyrtimit nën nën.

Ky element shton argumentin tonë që efektet e projektligjit nuk do të jenë të menjëhershme dhe nuk mund të kenë asnjë impakt në zgjedhjet e përgjithshme, **për sa kohë hyrja në fuqi do të bëhet sipas propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pas zgjedhjeve parlamentare të 11 Majit.**

### **Procedura parlamentare e ndjekur si për cdo projektligj tjetër, pa procedurë të përshpejtuar apo hyrje në fuqi menjehere**

Projektligji ka ndjekur një procedurë normale të depozitimit të tij dhe është në vijueshmëri shqyrtimi i tij në komisionin përgjegjës, pa iu nënshtruar asnjë procedure të përshpejtuar.

Projektligji është depozituar në Kuvend në datë 23 dhjetor 2024, është parashikuar në Programin e Kuvendit dhe në kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare dhe shqyrtimi i tij në komisionin përgjegjës është në vijim.

Për më tepër, fakti që projektligji po i nënshtrohet një faze të gjerë konsultimesh, dhe komisioni përgjegjës ka shprehur paraprakisht gadishmërinë e vijimit të seancave dëgjimore me grupet e interesit

dhe nëse është e nevojshme ato mund të vijojnë edhe pas zgjedhjeve apo në kundërt nëse zhvillohen përpara zgjedhjeve parlamentare, hyrja në fuqi do të bëhet pas zgjedhjeve parlamentare të 11 Majit, **“flet” për asnjë influencë të Kuvendit në këtë drejtim dhe mos interesim për të përshpejtuar goftë miratimin apo edhe efektet e tij.**

### Jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor dhe praktikat administrative të KQZ-së

Në jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor dhe praktikat administrative të KQZ-së, është theksuar qartë se ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale gjatë periudhës së ndalimit duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe të kufizuar. Kjo do të thotë se vetëm ato veprime që kanë një efekt të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në zgjedhje mund të konsiderohen si shkelje të Kodit Zgjedhor.

Në këtë rast, efektet e ligjit nuk janë të menjëhershme dhe nuk kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zgjedhjet. Prandaj, nuk mund të argumentohet se ligji ka qenë një mjet për të fituar përfitime elektorale.

### KONKLUZIONE

Për sa s'qaruar më sipër në mënyrë të përmbledhur Kuvendi i Shqipërisë argumenton se projektligji nuk cenon nenin 91, pika 4 dhe nuk ka asnjë bazë ligjore për të konsideruar se Kuvendi ka shkelur Kodin Zgjedhor ose aktet e tjera nënligjore në procesin e përfshirjes së këtij projektligji në kalendarin e tij pasi projektligji:

- i. *Nuk sjell përfitime të drejtpërdrejta financiare apo sociale për të dënuarit, por rregullon procedurat e klasifikimit të tyre.*
- ii. *Efektet e tij nuk janë të menjëhershme, pasi hyrja në fuqi është planifikuar pas zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025, gjithashtu nuk është propozuar pas datës 11 janar 2025 dhe as do të zbatohet brenda harkut kohor të ndaluar.*
- iii. *Projektligji është pjesë e një reforme administrative dhe jo një favor elektoral, duke u bazuar në një nevojë të kahershme për përmirësimin e menaxhimit të sistemit peniteciar.*
- iv. *Procedura legjislativë është ndjekur sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit dhe Kushtetutës, pa përshpejtim të qëllimshëm ose hyrje në fuqi të menjëhershme.*


### KËRKOJMË :

1. Shfuqizimin e pikës 1 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Konstatimin e pasaktësisë juridike të pikave 2 dhe 3 të vendimit nr.117, në kundërshtim me objektin e vendimit nr 117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë shfuqizimin e menjëhershëm të tyre.

3. Konstatimin se projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” nuk bie ndesh me nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor;

Genç GJONCAJ

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Ishqiptarja.com